

AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR


**UDHËZUES PËR PËRDORUESIT E WEB-IT QË
REGJISTROHEN NËPËRMJET PORTALIT E-ALBANIA NË
GJEOPORTALIN KOMBËTAR**

Miratohet:

14.10.2021

Lorenc Çala

Drejtor i Përgjithshëm



Three handwritten signatures in blue ink are located at the bottom right of the page.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Qëllimi	3
3. Procedura e regjistrimit të përdoruesve në Gjeoportalin Kombëtar nëpërmjet portalit E-Albania	3
4. Të drejtat që kanë përdoruesit e regjistruar nga E-Albania	6
5. Mënyrat e aksesimit të shërbimeve.	6
6. Termat dhe Kushtet e Përdorimit të Gjeoportalit Kombëtar	6



1. Hyrje


Bazuar në nenin 23 të ligjit Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) ka miratuar dhe publikon këtë udhëzues mbi përdoruesit e web-it që regjistrohen nëpërmjet E-Albania në Gjeoportalin Kombëtar.

2. Qëllimi


Qëllimi i këtij dokumenti është hartimi dhe publikimi për përdoruesit e web-it nga portali E-Albania i një udhëzuesi, i cili të përmbajë informacionin e plotë mbi mënyrën e regjistrimit, kur krijimi i përdoruesit është i nevojshëm, informimin e saktë dhe të qartë mbi mënyrat e aksesimit si dhe të drejtat dhe detyrimet që ka cdo përdorues i krijuar nga ndërfaqja web.

3. Procedura e regjistrimit të përdoruesve në Gjeoportalin Kombëtar nëpërmjet portalit E-Albania.


- Si fillim kryeni login në faqen zyrtare të Gjeoportalit Kombëtar .



- Me pas klikoni mbi butonin **Hyr nga e-albania** portali do të ju ridrejtojë tek ambienti i e-albania:




- Klikoni te **Identifikim si qytetar/biznes**.




- Më poshtë vendosni numrin ID dhe fjalëkalimin e llogarisë që keni në E-Albania. Ky shërbim ofrohet me anë të Government Gateway, ku çdo përdorues ka mundësinë që të regjistrohet më të njëjtat kredenciale me ato të llogarisë në e-albania.



- Klikoni mbi butonin **kthehuni në homepage** dhe shikoni që në homepage user i ardhur nga GG është i loguar:





4. Të drejtat që kanë përdoruesit e regjistruar nga E-Albania

Përdoruesit e regjistruar nga portali e-albania kanë të drejtë të shfrytëzojnë shërbimet e kërkimit dhe konsultimit të ofruara nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar. Shërbimi i shkarkimit të të dhënave bazuar në VKM nr.399, date 19.06.2019 “Për Rregullat për Shkëmbimin e Grupeve dhe të Shërbimeve të të Dhënave Gjeohapësinore ndërmjet Autoriteteve Publike” u ofrohet pa pagesë vetëm autoriteteve publike të regjistruara në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar në mënyrë zyrtare.

5. Mënyrat e aksesimit të shërbimeve

Mënyrat e aksesimit të shërbimeve të Gjeoportalit Kombëtar janë duke u loguar në sistem nëpërmjet website geoportal.asig.gov.al ose nëpërmjet aplikacioneve GIS desktop të cilat mundësojnë punimin në ambientin lokal duke përdorur të dhënat e aksesueshme nëpërmjet webservice-ve (WMS, WMTS).

6. Termat dhe Kushtet e Përdorimit të Gjeoportalit Kombëtar

Përdorimi i faqes <http://geoportal.asig.gov.al> (Gjeoportali) nënkupton pranimin e termave dhe kushteve të mëposhtme:

Përkufizime

Për qëllime të këtij dokumenti do të zbatohen këto përkufizime:



1. “Administrator i Gjeoportalit Kombëtar” është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor-“ASIG”, i cili krijon dhe mirëmban Gjeoportalin Kombëtar.
2. “Autoritet publik” është:
 1. çdo organ i pushtetit qendror dhe vendor, që kryen funksione administrative, si dhe entet publike që kryejnë funksione administrative;
 2. çdo person fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose kryen funksione publike apo që ofron shërbime publike nën kontrollin e autoriteteve të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike.
3. “Të dhëna gjeohapësinore” është çdo e dhënë që i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë një vendi ose zone gjeografike të veçantë.
4. “Gjeoportali” është një sistem, i cili nëpërmjet internetit përdor një ndërfaqe grafike qendrore dhe unike, nëpërmjet së cilës përdoruesit mund të zbulojnë, të shikojnë dhe të përdorin informacionin gjeohapësinor dhe shërbimet e rrjetit që lidhen me këtë informacion, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
5. “Informacion gjeohapësinor” janë metadatat, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen çfarëdo të realitetit, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët.
6. “Shërbime për informacionin gjeohapësinor” janë operacionet që mund të realizohen, përmes aplikacioneve kompjuterike, për informacionin gjeohapësinor, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore ose për metadatat që lidhen me to.
7. “Infrastruktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor” është infrastruktura që përfshin autoritetet kombëtare përgjegjëse për të dhënat gjeohapësinore, metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, shërbimet e rrjetit dhe teknologjitë, marrëveshjet për shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin, si dhe mekanizmat e koordinimit e të monitorimit, proceset dhe procedurat, të krijuara, të vëna në veprim ose të vëna në dispozicion në përputhje ligjin 72/2012.
8. “Përdorues” është çdo individ, person fizik apo juridik që përdor Gjeoportalin.

I. Të përgjithshme

1. Aksesi në informacionin gjeohapësinor dhe shërbimet e informacionit gjeohapësinor rregullohet nga:
 1. Ligji nr. 72/2012 datë 28.06.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën E Shqipërisë”
 2. Ligji Nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
 3. VKM Nr. 147 datë 20.02.2013 “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””
 4. Urdhër Nr. 42/2, datë 20.09.2016 “Për rregullat e shërbimeve të rrjetit”



2. Termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë dokument janë të vlefshme për:
 1. Përdoruesit privatë
 2. Institucionet publike
3. Çdo përdorues i Gjeoportalit duhet të njihet me kushtet dhe rregullat e përdorimit përpara se të përdorë Gjeoportalin Kombëtar.
4. Përdoruesit privatë dhe institucionet publike janë të detyruar të përdorin Gjeoportalin Kombëtar në përputhje me ligjin nr. 72/2012 Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” dhe me kushtet e këtij dokumenti.

II. Llojet dhe shtrirja e shërbimeve

Shërbimet gjeohapësinore të vëna në dispozicion nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar përfshijnë:

1. Kërkimin, me anë të të cilit bëhet i mundur kërkimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, në bazë të metadatave korresponduese në katalogun e metadatave dhe shfaqja e përmbajtjes së këtyre metadatave.
2. Konsultimin, me anë të të cilave bëhen të mundur minimalisht shfaqja, lundrimi, zmadhimi apo zvogëlimi, shtresëzimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore që shfaqen dhe shfaqja e legjendës së informacionit dhe të çdo përmbajtjeje relevante të metadatave.
3. Shkarkimin, me anë të të cilit mundësohet shkarkimi i kopjeve ose pjesëve të grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, aksesit i drejtpërdrejtë me to.
4. Transformimi, me anë të të cilit mundësohet transformimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore, me qëllim realizimin e ndërveprueshmërisë.

III. Kushtet / rregullat për përdorimin e të dhënave dhe shërbimeve nga përdoruesit

1. Aksesit ndaj shërbimeve të kërkimit dhe konsultimit të referuara në Kapitullin II, është i plotë dhe pa pasur nevojë për regjistrim, për të gjithë përdoruesit, publikë dhe privatë, të Gjeoportalit Kombëtar.
2. Përdoruesit kanë të drejtë të përdorin burimet e Gjeoportalit Kombëtar vetëm për qëllime jo-fitimprurëse dhe jo-komerciale, në përputhje me parashikimet e ligjit 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën E Shqipërisë” dhe ligjit nr. 35/2016 datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
3. ASIG në përputhje me nenin 26 të ligjit 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën E Shqipërisë”, aplikon tarifa për shërbimet e shkarkimit dhe transformimit.

IV. Kushtet / rregullat për shkëmbimin e të dhënave gjeohapësinore nga autoritetet publike.



1. Autoritetet publike shkëmbejnë ndërmjet tyre grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga ASIG-u, sipas pikës 4 të nenit 12 të ligjit 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën E Shqipërisë”, duke i garantuar njëri-tjetrit aksesin tek ato dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllime të ushtrimit të funksioneve të tyre publike.
2. Aksesin në të dhënat gjeohapësinore të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar (Shërbimi i shkarkimit) është pa pagesë për autoritetet publike, kundrejt regjistrimit sipas procedurës së përcaktuar, vetëm në funksion të kryerjes së detyrave të tyre publike.

V. Kushtet teknike të përdorimit të të dhënave dhe shërbimeve në Gjeoportalin

1. Për përdorimin në Gjeoportalin Kombëtar të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, është e nevojshme:

1. një lidhje interneti;
2. një pajisje që mundëson aksesin në internet, si dhe programe (web browser, web GIS) që bëjnë të mundur shfaqjen dhe importimin e të dhënave të Gjeoportalit.

2. Gjatë përdorimit të Gjeoportalit Kombëtar është e ndaluar:

1. Përdorimi i viruseve, bots, worms ose kode të tjera kompjuterike, Scripts apo programe që ndërpresin, kufizojnë funksionimin e Gjeoportalit apo shërbimeve të tij, ose që lejojnë përdorimin e paautorizuar të shërbimeve me akses të kufizuar.
2. Përdorimi i kodeve kompjuterike, Scripts apo programeve automatike në përdorimin e shërbimeve të ofruara nga Gjeoportali Kombëtar.

VI. E drejta e autorit

Përmbajtja e kësaj faqeje dhe e burimeve të saj është e mbrojtur nga legjislacioni shqiptar në fuqi, konkretisht nga:

1. Ligji nr. 35/2016 datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
2. Ligji nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.

VII. Informacion shtesë

Për sqarime më të hollësishëm në lidhje me përmbajtjen e këtij dokumenti, mund të kontaktoni Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, me adresë : Rruga “Papa Gjon Pali” Nr 3, Kati 2, Tiranë , e mail: info@asig.gov.al dhe info.geoportal@asig.gov.al.

VIII. Dispozita të fundit

1. Këto terma dhe kushte zbatohen nga data e publikimit në Gjeoportalin Kombëtar.
2. Këto terma dhe kushte janë pa pagesë në një format që lejon shkarkimin, dhe printimin e tyre.



3. Këto terma dhe kushte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi posaçërisht ligjin nr. 72/2012 datë 28.06.2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën E Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
4. Administratori (ASIG) nuk është përgjegjës për mungesën e aksesit në Gjeoportalin Kombëtar për arsye që nuk varen prej tij.
5. Administratori(ASIG), për arsye sigurie dhe për çfarëdo shkakuj tjetër pamundësie, ka të drejtë të pezullojë përkohësisht aksesin në Gjeoportalin Kombëtar, deri në zhdukjen e kushteve të pamundësisë.
6. Administratori i Gjeoportalit (ASIG), nuk është përgjegjës për dëmet që rrjedhin nga përdorimi i të dhënave të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar, që lidhen me gabime, defekte apo shtrembërime që kanë të bëjnë me autoritetin publik përgjegjës, për krijimin, përpunimin dhe përditësimin e tyre, apo nga mosrespektimi i termave dhe kushteve nga përdoruesit.
7. Këto terma dhe kushte mund të ndryshohen në çdo kohë dhe në çdo aspekt. Ndryshimet hyjnë në fuqi pas publikimit në faqen e Gjeoportalit Kombëtar.
8. Administratori i Gjeoportalit (ASIG) nuk mban përgjegjësi për saktësinë, apo cilësinë e të dhënave të pasqyruara në faqet e internetit (gjeportalë të tjerë) të cilat mund të aksesohen përmes faqes së Gjeoportalit Kombëtar.

